



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr \_\_\_\_prot

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**VENDIM**

**Nr. 261, datë 16.05.2024**

**PËR**

**MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT**  
**PËR GJYQTAREN E GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT**  
**TË PËRGJITHSHËM ELBASAN, ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe në pikën 3, të nenit 65, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit mbi shkaqe të motivuara, me propozim të Relatorit z. Alban Toro,

**VENDOSI**

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për znj. {...}, gjyqtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për shkak të dorëheqjes së saj nga ky status.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.05.2024.
3. Të përjashtojë gjyqtaren znj. {...} nga procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
4. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**